# DËSHMI ARKIVI

**A-442361**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nga data 14 deri 19 Shtator Akademia Marubi organizon Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kulture/nga-data-14-deri-19-shtator-akademia-marubi-organizon-festivalin-nderkom-i585957` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 08:28:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 08:25:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d563ae2160fdbc10912c72df2f4965d4c91da6c7485b87cd3a620a5ea0a151de` |
| TEKSTI | `2031f04597f7bf393a6169f2050195a6c0cb0a9619893ca9822eaff7af6da209` |
| PAMJA | `6a4e1c38a5a7846b116f6a64f05182d51abc04cdb9f39e9d97a94900a47f12bc` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6783d06fd13a5e3c3827ddd7bd0c1b7ed09c83f4877006d1253549556d032f5e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a9dba7e1cf5e08da052e8f7bcad4dfd2bc0436d1ed5e23cf11abc817a3e1dcfc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6783d06fd13a5e3c3827ddd7bd0c1b7ed09c83f4877006d1253549556d032f5e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Nga data 14 deri 19 Shtator Akademia Marubi organizon Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut

TemA

14 Shtator 2026, 10:25Kulturë TEMA

Edicioni i 21-të i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e njeriut, organizuar nga Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi", mbahet në Tiranë në datat 14-19 shtator. Me temën "Lufta, vendosja e paqes, shteti i se drejtës dhe përkujtimi i viktimave", në 6 ditë, festivali shfaq filma që trajtojnë subjekte me histori komplekse të luftërave aktuale, lidhen me memoriet arkivore materiale e shpirtërore dhe memoriet e viktimave dhe të zhdukurve.






“Një sërë normash etike e morale po përplasen me interesa shfrytëzuese burimesh natyrore e njerëzore, në formë izomorfike mbi rrjedhën e pandalshme të historisë së njerëzimit. Në program kryesisht janë përzgjedhur filma nga kontinenti Europian, i cili gjendet sërish në luftë, duke vënë në rrezik ekzistencën e tij dhe arritjeve të realizuara në dekadat e pas luftës së dytë botërore”, thotë drejtori Ekzekutiv, Kujtim Çashku.

Përmes filmave, Rusia, Natos dhe Kina, shfaqen krahas interesa të ndryshme.






Strategjike, ndërsa marrëdhëniet mes Evropës dhe Amerikës, të rimodeluara nga presidenti Trump bëhen edhe më të qarta në filmin "Defending Europe". Transferta e pushtetit drejt inteligjencës artificiale si pushtet i së mundshmes, jashtë kontrollit njerëzor, mund të ndryshojë të gjithë strukturën shoqërore dhe kushtet e marrëdhënieve njerëzore. Festivali shfaq filma mbi: rolin e medias, nivelin e propagandës që bart vetë gazetari; rolin e policisë në ruajtjen e rendit në protesta dhe në demokraci; si edhe luftën e Kosovës, përmes filmit "Dua" të Blerta Bashollit, që shfaqet më 18 shtator në orën 19:30.

Filmi që hap festivalin, të hënën në mbrëmje, në orën 19:00, titullohet "SUNDAYS", Spain, France / 2025 / Fiction/117 min dhe është fitues i 4 çmimeve në Goya Awards.

Në ditët në vijim, filmat do të shfaqen, në Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi, në Shkollën e Magjistraturës, në Akademinë e Sigurisë, te Autoriteti për Informim mbi Dosjet e ish Sigurimit të Shtetit, duke dërguar në secilin prej tyre, filma tematikë që kanë të bëjnë me fusha të ndryshme të jetës e të të drejtave të njeriut.

Per me shume,

Link ne facebook: Facebook

Link ne web: International Human Rights Film Festival Albania

Link ne youtube per trailera: IHRFFA - YouTube

A.K./TemA

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rreth 90 banesa monument kulture në Gjirokastër pritet të shpëtohen nga ndërhyrjet e shtetit]

08:43 Kulturë


Arti përtej kohës

18:40 Kulturë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.